



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

---

Numri i lëndës: 2021:110963

Datë: 27.12.2024

Numri i dokumentit: 06661058

**C.nr.525/2022**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË–  
Departamenti i Përgjithshëm– Divizioni civil**, me gjyqtar Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonit Çoçaj, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësve M.K, V.K dhe L.B, që të gjithë nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat B. M, nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Fatlum Hodaj, nga Prizreni, me objekt të çështjes kontestimore – Kompensim Dëmi, gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.17.12.2024, me datë 27.12.2024 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET pjesërisht** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve M.K, V.K dhe L..B, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material.

**II. DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “ELSIG”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të paguajë shumat dhe atë:

Në emër të dëmit material, për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores, shumën prej 3,000.00 euro;

Në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, këtu paditësve t’ua kompensoj shumat, si në vijim:

Për paditësin Mifail Kurtaj, bashkëshort i të ndjerës, shumën prej 12,000.00 euro;

Për paditësin V. K, i biri i të ndjerës, shumën prej 10,000.00 euro;

Për paditësin L. B, e bija e të ndjerës, shumën prej 10,000.00 euro;

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 35,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, obligohet e paditura që t'ia paguaj paditësve në afatin prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**III. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si e pabazuar.

**IV. OBLIGOHET** e paditura, që t'ia paguajë paditësve shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë shumën në lartësi prej 2,188.40€ (dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë euro e katër dhjetë cent), në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, avokat B. M, pranë kësaj gjykate me datë 07.06.2021, kanë parashtruar padinë me numrin C.nr.525/2021, përmes së cilës kanë kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material nga e paditura Kompania e Sigurimit "Elsig", me seli në Prishtinë, për shkak të aksidentit të shkaktuar nga automjeti i siguruar pranë të paditurës, aksident ky i shkaktuar me datë 08.01.2021, në autostradën Duhël – Suharekë, ku si pasojë e këtij aksidenti ka ndërruar jetë K. K, bashkëshortja e paditësit M. K, përkatësisht e ëma e paditësve V. K dhe L. B. Andaj, paditësit kanë kërkuar të aprovohet kërkesëpadia, duke e detyruar të paditurën që të kompensojë paditëseve shumat dhe atë për shpenzime të varrimit dhe ngritjes së përmendores shumën prej 10,000.00 euro, si dhe për secilin nga paditësit shumën nga 20,000.00 euro, në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara si pasojë e humbjes së anëtarit të familjes. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, në seancën gjyqësore të datës 16.10.2024 dhe në fjalën përfundimtare të datës 17.12.2024 kanë deklaruar se në rastin konkret nuk është kontestuese baza e kërkesëpadisë, pasi që, shkaktari i aksidentit ishte i siguruari i të paditurës, fakt ky i pa kontestuar edhe nga e paditura. Lidhur me lartësinë e dëmit të pësuar nga ky aksident, marrë parasysh karakteristikat e rastit,

ku shkaktues i aksidentit ishte familjari i paditësve dhe i të ndjerës, dhimbjet shpirtërore në këtë rast janë më të mëdha se në rastet e tjera, pasi që në ditë të veçanta përkujtime sa herë shohin familjarin e tyre, dhimbja është shumë e madhe. Andaj në rastin konkret ka kërkuar që të aprovet kërkesëpadia e paditësve, duke i njohur kështu edhe shpenzimet ceremoniale të varrimit dhe ngritjes së përmendores, si dhe kompensimin në emër të dhimbjeve shpirtërore për anëtarët e familjes. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar në shumën prej 2,188.40 euro dhe atë për taksë gjyqësore 150 euro, për padi 416 euro, për pjesëmarrje në 3 seanca nga 540.80 euro.

Pala e paditur, përmes përfaqësuesit të saj, në seancën gjyqësore të datës 17.12.2024, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka bërë ofertë për paditësit, për shkak të mungesës së dokumentacionit mjekësor, e po ashtu të raportit të aksidentit. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, konkretisht ti bëhet kompensimi për dhimbjet shpirtërore, në përputhje me rregulloren e aprovuar nga BQK.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata në seancën e dt.17.12.2024 ka administruar provat si në vijim:

- Kallëzimi penal, me numër të rastit 2021-TR-014, i datës 08.01.2021, lëshuar nga Policia e Kosovës;
- Raporti i Aksidentit me numër 2021-TR-014, i datës 08.01.2021, lëshuar nga Policia e Kosovës;
- Letërnjoftimet personale dhe atë për paditësin M. K ID1188869, për paditësin V. K ID147342 dhe për paditësen L. B, ID03737210;
- Certifikata e vdekjes e të ndjerës K. K, e datës 09.02.2021;
- Certifikata e martesës mes paditësit M. K, dhe të ndjerës K. R, e datës 03.02.2021;
- Deklarata për bashkësinë familjare, e datës 01.03.2021, me numër F11040361;
- Certifikata e martesës me numër M 11113435, e datës 03.02.2021;
- Certifikata e lindjes e paditëses L. B, e datës 09.03.2021, me numër E25001613;

Andaj, gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se, ***kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.***

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese fakti se me datë 08.01.2021, rreth orës 10:00h, ngasësi i automjetit S. K, i cili ishte i siguruar pranë të paditurës, fakt ky i vërtetuar edhe nga vet deklarata e të paditurës, ashtu që, derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tij në autostradën Suharekë – Duhël, nga pakujdesia ka shkaktuar aksident komunikacioni, ashtu që nga mospërshtatja e shpejtësisë dhe kushteve të rrugës, drejtuesi humb kontrollin mbi veturë, dhe fillimisht kthehet djathtas dhe me pjesën e përparme ballore i godet mbrojtësit e metaltë të rrugës në anën e djathtë shikuar drejtimin e lëvizjes së veturës. Si pasojë e kësaj goditje vetura kthehet në mënyrë të pa kontrolluar në anën e majtë dhe me pjesën e prapme të krahut të majtë i godet persi mbrojtëset e metalta në anën e majtë shikuar drejtimin e lëvizjes së veturës para aksidentit dhe në momentin e goditjes dyshohet se dy pasagjeret të cilat ishin të ulura në ulëset e pasme të automjetit hidhen jashtë veturës përmes derës së pasme të majtë të veturës ndërsa vetura vazhdon edhe më tutje lëvizjen në mënyrë të pakontrolluar nga shoferi dhe ndalet në shiritin e majtë. Ky fakt vërtetohet edhe përmes Kallëzimit penal, me numër të rastit 2021-TR-014, i datës 08.01.2021, lëshuar nga Policia e Kosovës dhe Raportit të Aksidentit me numër 2021-TR-014, i datës 08.01.2021, lëshuar nga Policia e Kosovës. Si pasojë e këtij aksidenti shkaktohen dëme të mëdha materiale në veturë dhe mbrojtëset e metalta, ndërsa lëndime trupore vdekjeprurëse merr K. K, fakt ky i vërtetuar edhe përmes Certifikatës së vdekjes së të ndjerës K. K, e datës 09.02.2021, e cila ishte bashkëshortja e paditësit M. K, vërtetuar përmes Certifikatës së martesës me numër M 11113435, e datës 03.02.2021, ku martesa ishte lidhur me datë 05.03.1979, përkatësisht ishte e ëma e shkaktuesit të aksidentit S. K , paditëseve V. K, dhe L. B, fakt ky i vërtetuar përmes Deklaratës për bashkësinë familjare, e datës 01.03.2021, me numër F11040361 dhe Certifikatës së lindjes e paditëses L B, e datës 09.03.2021, me numër E25001613. Si pasojë e këtij aksidenti, lëndime trupore pësojnë edhe personat e tjerë të cilët ishin në veturë.

Kontestuese nuk ishte as e drejta e kompensimit të paditësve, pasi pala e paditur, përmes përfaqësuesve të tyre, deklaruar në seancat gjyqësore, të cilat kishte shtuar se nuk e kundërshton kërkesëpadinë e paditësve për të njohur të drejtën e kompensimit mbi bazën e dhimbjeve shpirtërore, por kontestuese ishte lartësia e kompensimit, përmes së cilës kishte kërkuar që të aprovohej duke u bazuar në rregulloren e BQK.

Andaj, lidhur me këtë gjykata vlerëson se e paditura ka detyrim ligjor, në kuptim të nenit 136 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet Detyrimeve, që të kompenzon paditësit, pasi që *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*.

Në kuptim të nenit 137 të LMD-së, *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuar të dëmit, gjykata vendosi në kuptim të nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, sipas të cilit është paraparë që *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës”*.

Konkretisht, në nenin 184 parashihen personat që kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rast vdekjeje, në rastin konkret vdekjes së bashkëshortes, përkatësisht të ëmës së paditësve, ashtu që thuhet se citojmë: *“Në rast vdekjeje të ndonjë personi, gjykata mund t`ua caktojë anëtarëve të familjes së tij të ngushtë (bashkëshortit, fëmijët dhe prindërit) shpërblim të drejtë në të holla për dhembjen e tyre shpirtërore. Ky shpërblim mund t`u caktohet edhe vëllezërve dhe motrave në qoftë se ndërmjet tyre dhe personit të vdekur ka ekzistuar bashkëjetesa e vazhdueshme”*.

Në rastin konkret, me rastin e caktimit të lartësisë së shpërblimit për shkak të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, gjykata është bazuar në Udhëzuesin nr.41/2023, të datës 27.02.2023, nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, i cili udhëzues ka të bëjë me caktimin e kriterëve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, në të cilin udhëzues parashihen vlerat nominale për shpërblimin me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, për shkak të dhimbjeve shpirtërore të pësuar.

Andaj, në rastin konkret gjykata ka vendosur të aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që të detyrojë të paditurën në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të paguajë shumat dhe atë: Në emër të dëmit material, për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores, shumën prej 3,000.00 euro, Në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara, këtu paditësve t`ua kompensoj

shumat, si në vijim, Për paditësin M. K, bashkëshort i të ndjerës, shumën prej 12,000.00 euro, Për paditësin V. K, i biri i të ndjerës, shumën prej 10,000.00 euro, Për paditësin L. B, e bija e të ndjerës, shumën prej 10,000.00 euro. shuma këto që sipas çmuarjes së lirë të gjykatë , bazuar ne nenin 323 të LPK-së janë satisfacion real për dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga palët e dëmtuara.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material dhe material gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse, sa i përket dëmit material, konkretisht për shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores gjykata ka refuzuar një pjesë të kërkesës, pasi që paditësit nuk kanë prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar, ndërsa lartësia e kërkesës për gjykatën nuk është në përputhje me shpenzimet e zakonshme që shkakton në këto raste e as me shpenzimet e gjykuara nga gjykatat tona, tashmë ka praktik të ndërtuar për këtë qështje.

Lidhur me kamatën ligjore gjykata vendimin e mori në përputhje me nenin 382 të LMD-së si dhe M. Juridik të Gjykatës Supreme për Kamatën, me numër 265/2020, të datës 02.12.2020.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerr konform nenit 452 të LPK-së dhe tarifës zyrtare të OAK-s, obligohet e paditura që palës paditëse t'ia paguaj shpenzimet si në vijim: për përpilimin e padisë 416 euro, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 150 euro, për tri seanca të mbajtura nga 540.80 euro, në shumën prej 1,622.40 euro, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 2,188.40€ (dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë euro e katër dhjetë cent).

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sipas nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS  
SUHAREKË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.525/2021, datë 27.12.2024**

**r i**

**G j y q t a**

**Robert Tunaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.